
BULETIN INFORMATIV

QERSHOR 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Qershor, 2025

Përmbajtje

Projekti CryoConnect	5
U mbajt mbledhja e parë e partnerëve të projektit CryoConnect: Një iniciativë rajonale për kriobankë ndërkufitare në vendet e Ballkanit Perëndimor	6
Aktivitete	9
U mbajt konferenca “Shteti dhe e drejta në veprën e akademik Luan Omarit, me rastin e 100-vjetorit të lindjes”	10
Konferencë shkencore dhe ekspozitë kushtuar Karl von Gegës dhe hekurudhës së Semmering-ut: një inxhinier vizionar që ndryshoi historinë e Europës së shek. XIX..	15
Konferenca ndërkombëtare “Menaxhimi i integruar i burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit” – një platformë bashkëpunimi shkencor mbarëkombëtar.	19
Nisin punimet dyditore të Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s.....	23
U zhvillua konferenca e tretë ndërkombëtare e Institutit Kombëtar të Fizikës	25
U mbajt në Prishtinë konferenca shkencore me temën “Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës 1912–2008”	29
U mbajt forumi shkencor me temën "Programet e studimit të doktoraturës në fizikë e kimi; vlerësime e mendime për të ardhmen"	33
U mbajt ligjërata me temën “Për një klasifikim tipologjik të modalitetit në gjuhën shqipe” nga dr. Leonard Dauti.....	36
U mbajt forumi shkencor “Meteorologjia dhe aviacioni 100 vjet në hapësirën shqiptare”	38
U mbajt forumi shkencor me temën “Risku sizmik dhe zvogëlimi i tij”	41
Akad. Adrian Civici mbajti ligjëratën: “Drejt universiteteve 4.0. - Si po e revolucionarizon teknologjia dhe inteligjenca artificiale edukimin”	43
Tryezë e rrumbullakët: “Studimet historike shqiptare sot: sfida dhe probleme”	45
U mbajt forumi ndërkombëtar “Arkitektura e peizazhit në Shqipëri: sfida dhe potenciale”	49
Arkeologët zviceranë dhe shqiptarë përmbyllin fazën e parë të gërmimeve në Lin të Pogradecit.....	52

Vizitë pune	54
Vizitë zyrtare e delegacionit të Akademisë së Shkencave Sociale të Shangait në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.....	55
Të reja nga bota akademike	58
Akademik Nazim Gruda merr diplomën si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Lituanisë	59
Botime të reja	60
Doli numri i parë i revistës shkencore “Albanian Studies” për vitin 2025!	61
Të tjera.....	62
Urim për 89-vjetorin e lindjes së akademikut Rexhep Qosja	63
Vizitë zyrtare e akad. Skënder Gjinushit në fondet arkeologjike të Durrësit.....	65
Specialistët e informacionit në institucionet kërkimore marrin licensa për digjitalizimin e veprimtarisë shkencore.....	66

Projekti CryoConnect

U mbajt mbledhja e parë e partnerëve të projektit CryoConnect: Një iniciativë rajonale për kriobankë ndërkufitare në vendet e Ballkanit Perëndimor

Veprimtaria u zhvillua sot, më 25 qershor 2025, me pjesëmarrjen e studiuesve nga Shqipëria, Italia, Çekia, Gjeorgjia, Serbia, Kroacia, Maqedonia dhe vende të tjera të rajonit.

Akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, si dhe akad. Ilia Mikerezi, kryetar i Komisionit të biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë, u uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve në këtë takim dhe i falënderuan për bashkëpunimin me studiuesit shqiptarë e kontributin që kanë dhënë në mbarëvajtjen e projektit CryoConnect: Një iniciativë rajonale për kriobankë ndërkufitare në vendet e Ballkanit Perëndimor.



Projekti zhvillohet në vijim të veprimtarive të Qendrës së Kërkimit Shkencor “Bioteknologji & Gjenetikë” (QKBGJ), pjesë e Akademisë së Shkencave; Universitetit të Tiranës, si dhe institucioneve partnere ballkanike e më gjerë.

Synimi i këtij takimi ishte prezantimi i kërkimit shkencor dhe përvojës së deritanishme në kriokonservimin e gjermpoplazmës bimore rajonale, si dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira.

Akad. Anila Hoda, sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave, përshëndeti pjesëmarrësit në emër të Kryesisë. Ajo shprehu mirënjohjen për punën që është bërë për

realizimin e projektit dhe theksoi ndër të tjera rolin dhe arritjet e Akademisë së Shkencave me institutet, qendrat kërkimore dhe seksionet e saj në kërkimin shkencor në tërësi, e sidomos në fushën e gjenetikës dhe bioteknologjisë së aplikuar, si dhe në zgjerimin e bashkëpunimeve me rrjetet ndërkombëtare e rajonale të kërkimit shkencor.

Takimin e përshëndeti edhe akad. Genc Sulçebe, drejtues i Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, pjesë e ASHSH-së. Ai theksoi se QKBGJ-ja ka dhënë kontribut në kërkimet e shumta shkencore, përfshirë dhe ato të lidhura me bioteknologjinë bimore, e veçanërisht me ruajtjen kriogjenike të gjermoplazmës bimore me interes, përmes organizmit të projekteve dhe studimeve të përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë e të shkencës dhe nëpërmjet krijimit e angazhimit të rrjetit europian e rajonal të bashkëpunëtorëve.



Më tej, gjatë kësaj seance, dr. Lorenzo Maggioni (Sekretar ekzekutiv i ECPGR) dhe dr. Miloš Faltus (kryetar i grupit të punës për kriokonservimin në ECPGR) theksuan domosdoshmërinë e krijimit të bashkëpunimeve të kësaj natyre dhe rëndësinë e përfshirjes së teknikave të ruajtjes afatgjatë nëpërmjet kriokonservimit të gjermoplazmës bimore autoktone.

Në takim mbajtën referime dhe palët partnere: dr. Darko Jevremovic dhe dr. Tatjana Vujovic nga Serbia, dr. Zvezdana Markovic nga Kroacia dhe dr. Tekle Zakalashvili nga Gjeorgjia.

Për palën shqiptare u pasqyrua një panoramë e plotë mbi zhvillimet në

bioteknologjinë bimore in vitro dhe aplikimet më të fundit me qëllim ruajtjen afatgjatë nga akad. Efigjeni Kongjika dhe prof. dr. Valbona Sota, të cilat veçanërisht theksuan dhe mbështetjen e ASHSH-së në mbarëvajtjen e këtyre nismave të reja shkencore për vendin tonë.



Organizimi i këtij takimi në Shqipëri zyrtarizon zbatimin e projektit, duke vendosur një bazë të përbashkët pune për të gjithë partnerët.

www.akad.gov.al

Aktivitete

U mbajt konferenca "Shteti dhe e drejta në veprën e akademik Luan Omarit, me rastin e 100-vjetorit të lindjes"

Veprimtaria u zhvillua me rastin e 100-vjetorit të lindjes të akad. emeritus Luan Omarit nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Konferenca u drejtua nga akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe akad. Aurela Anastasi.

Akad. Hoxha përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për këtë veprimtari unike që mbahet në përvjetorin e 100-të të lindjes së njërit prej themeluesve të Akademisë së Shkencave, akad. emeritus Luan Omarit, të një shkencëtari të suksesshëm dhe të një njeriu me dinjitet shumë të lartë.

Në emër të Kryesisë së ASHSH-së, akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave, përshëndeti të pranishmit dhe familjarët e akad. Omarit. Ai u shpreh se në këtë përvjetor i cili është i pari i një akademiku në Shqipëri që feston 100-vjetorin mes nesh, e njëherazi i fundit nga akademikët që themeluan Akademinë tonë të Shkencave në vitin 1972. Ne, nuk nderojmë thjesht një jetë të gjatë, por një jetë të shkrirë me shkencën, me mendimin shkencor, vlerësojmë një jetë të tërë të lidhur me sistemin universitar dhe me ndërgjegjen juridike të këtij vendi.



Akad. Tole theksoi se emri i akad. Omarit renditet pranë Budës, Çabejt, Shuteriqit, Kostallarit, Domit, Pollos, Kadaresë, Agollit, jo si pasues, por si

bashkudhëtar i tyre! Në fund të fjalës së tij, ai e vlerësoi akad. emeritus Omarin si jurist të lartë, themelues të ligjshmërisë së re shqiptare dhe si një zë të respektuar në tribunat europiane, përrurues dhe drejtues i suksesshëm institucional të ASHSH-së, përfaqësues të denjë të botës akademike, europiane dhe rajonale që ka dhënë një kontribut shkencor në mbi 6 dekada.

Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja, mbajti një fjalë përshëndetëse në emër të Qeverisë së Shqipërisë dhe të institucioneve të drejtësisë. Ai e vlerësoi akad. Omarin si një prej figurave më të mëdha të mendimit juridik dhe të shkencës kushtetuese shqiptare si dhe shprehu mirënjohje të thellë për kontributet e jashtëzakonshme të cilat kanë lënë gjurmë të thella në historinë e shtetit shqiptar, në sistemin tonë juridik në formimin e mendimit demokratik në vend, si dhe për formimin e brezave të juristëve. Ai theksoi se vepra e akad. Omarit nuk është thjesht një trashëgimi akademike. Ajo është pjesë e gjallë e institucioneve tona, e ligjeve tona dhe e vizionit tonë për një Shqipëri më demokratike, më të drejtë dhe më europiane.



Fjalë përshëndetëse mbajti edhe dekani i Fakultetit të drejtësisë, UT, prof. asoc. Erjon Muharremaj. Ai shprehu vlerësimet për personalitetin e akad. Omarit si një nga gurëvënësit e themelit të Fakultetit të Drejtësisë si zëvendësrektor i Institutit të Lartë Juridik që nga themelimi i tij në 1957-n dhe pastaj si dekan i parë i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës plot 17 vjet me radhë; të cilin e ka drejtuar me një integritet të jashtëzakonshëm personal dhe profesional, me një urtësi dhe pasuri njohurish erudite; duke dhënë gjithashtu kontribut në kushtetutën e 1976-s e dhe me pas në projekt-kushtetutën e 1991-shit e 1993 -shit dhe me kontribut të jashtëzakonshëm si akademik, por veçanërisht si qytetar; për forcën e mendimit, argumentit dhe

skrupulozitetit në punën e tij si profesor e akademik.

Ndërkohë, një letër urimi erdhi për 100-vjetorin e akad. Omarit në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës nga kryetari i saj akad. Mehmet Kraja. Letrën e lexoi akad. Anila Hoda sekretare shkencore e ASHSH-së.

Përmes kësaj letre, Kryesia e ASHAK-ut shpreh mirënjohjen për kontributin e veçantë shkencor të akad. Omarit. Akad. Kraja thekson ndër të tjera se "Duke qenë njëri nga themeluesit e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Luan Omari tashmë është bërë sinonim i këtij institucioni të rëndësishëm të dijes shqiptare. Vepra shkencore e Luan Omarit përfshin një opus të gjerë studimesh dhe monografish studimore me një gamë të gjerë interesimesh nga fusha e shkencave juridike dhe shkencave shoqërore në përgjithësi. Përveç kontributeve të tjera, në vitin 2009 akademik Omari botoi veprën "Kushtetuta e Kosovës në një vështrim krahasues".

Pas fjalëve përshëndetëse, akad. Aurela Anastasi drejtoi punimet e konferencës. Seanca nisi me kumtesën me temën "Shteti dhe e drejta në veprën e prof. Luan Omarit" nga prof. dr. Arta Mandro. Ajo shprehu vlerësim dhe përlulësi ndaj punës dhe kontributit të akad. Omarit në edukimin ligjor si institucion dhe në atë të shtetit dhe të së drejtës si përbërësit e domosdoshëm të demokracisë.

Më pas prof. dr. Ksenofon Krisafi mbajti një kumtesë me temën "Minoritetet në analizat juridike të prof. Luan Omarit". Ai e vlerësoi akad. Omarin si një figurë emblematike në fushën e së drejtës dhe si një zë të rëndësishëm në debatin publik mbi çështjet kushtetuese dhe administrative në promovimin e vlerave demokratike dhe të të drejtave të njeriut në Shqipëri, për reformën në gjyqësor, qeverisjen demokratike e më gjerë.



Akad. Aurela Anastasi mbajti kumtesën me temën “Prof. Luan Omari për format e qeverisjes. Refleksione”. Ajo tha se akad. Omari ka një kontribut origjinal në veprimtarinë juridike dhe të shkencës kushtetuese shqiptare. Në veprën e tij një vend të rëndësishëm zë edhe trajtimi i raporteve me pushtetin gjyqësor, të cilin e shikon të lidhur ngushtë me pavarësinë, shmangien e ndërhyrjeve të pushtetit politik ndaj tij si dhe eliminimin e korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në fushën e hartimit të kushtetutave ai është një shkollë mendimi në Shqipëri, e cila na shërben sot dhe do t’u shërbejë brezave në vijim.



Pas kësaj kumtese, studentë të Fakultetit të Drejtësisë së UT-së lexuan citate të përzgjedhura nga vepra e prof. Luan Omarit, duke shprehur mirënjohjen për njohuritë që përcjell në brezin e ri.

Seanca vijoi me kumtesën me temën “ Gjykata Kushtetuese në shekullin XXI dhe vepra e prof. Luan Omarit” nga prof. dr. Marjana Semini. Ajo fillimisht shprehu vlerësime dhe emocione për këshillat me natyrë akademike dhe shkencore të akad. Omarit dhe foli më tej për rëndësinë veprës së shkruar, ku ligjëroi ndërkohë pjesë të zgjedhura nga vepra e tij që nënvizojnë kontributin që ka luajtur për rolin dhe rëndësinë e Gjykatës Kushtetuese në ushtrimin e kompetencave të saj me natyrë kontrolluese ndaj akteve të Kuvendit dhe të Presidentit, kur ato bien ndesh me

Kushtetutën, ku ndër të tjera ai ka trajtuar kufijtë e interpretimit të kushtetutës dhe të ligjeve brenda kompetencave të Gjykatës Kushtetuese.

Për kontributin e akad. Luan Omarit në rolin e gjykatës kushtuese foli më gjerësisht edhe prof. dr. Evis Alimehmeti, e cila paraqiti një reflektim të përgjithshëm mbi mendimin teorik të tij, përqasur me reformat në drejtësi, me zbatim në Shqipëri, me një nga objektivat parësore forcimin e pavarësisë e gjyqësorit: siç shprehet akad. Omari pavarësia e gjyqësorit është strumbullari i shtetit të së drejtës.

Pas kumtesave pjesëmarrësit shprehën fjalë mirënjohëse për kontributin e veprës së akad. Omarit dhe vlerësuan personalitetin e tij.



Në fund, vajza e akad. Omarit, prof. dr. Anila Omari, mbajti një fjalë falënderuese për zhvillimin e kësaj veprimtarie duke shprehur mirënjohjen për Kryesinë e ASHSH-së, përfaqësuesit e qeverisë, organizatorët, si dhe për personalitetet, profesorët e nderuar të jurisprudencës e marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilët vlerësuan kontributin e akad Omarit në këto fusha.

www.akad.gov.al

Konferencë shkencore dhe ekspozitë kushtuar Karl von Gegës dhe hekurudhës së Semmering-ut: një inxhinier vizionar që ndryshoi historinë e Europës së shekullit XIX

Më 12 qershor 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua konferenca shkencore me temën “Karl von Gega dhe Semmering-u: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë”, kushtuar inxhinierit vizionar që la gjurmë në zhvillimin e Evropës së shekullit të 19-të. Veprimtaria u organizua në bashkëpunim me Musei Civici di Venezia dhe Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).



Akad. Gëzim Hoxha, kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, hapi konferencën dhe përshëndeti pjesëmarrësit. Më pas, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushi, mbajti fjalën përshëndetëse, duke shprehur mirënjohje për organizatorët, Muzeun “Correr” të Venecias dhe miqtë italianë që kontribuan në organizimin e konferencës dhe ekspozitës kushtuar Karl Gegës. Ai falënderoi veçanërisht profesoreshën Lucia Nadinin për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Akademinë e Shkencave.



Akademik Gjinushi theksoi se Karl Gega renditet ndër 100 figurat kryesore të historisë së Austrisë, krahas emrave të mëdhenj, si Moxarti, Shuberti, Shtrausi, Frojdi, Maria Tereza, Franc Jozefi dhe Franc Kafka. Ai u shpreh se krenaria për origjinën shqiptare të Karl Gegës nuk ka për qëllim përvetësimin, por përmbush një detyrim moral dhe shkencor, duke e pasuruar portretin e këtij gjeniu.

Monica Viero, përfaqësuese e Fondacionit Musei Civici di Venezia, falënderoi organizatorët për nismën e bashkëpunimin dhe përmendi mbështetjen e kryeministrit Edi Rama për promovimin e figurës së Karl Gegës. Ajo shprehu mirënjohje për akad. Skënder Gjinushin, kryetarin e Akademisë së Shkencave; akad. Gëzim Hoxhën, si dhe për Lucia Nadinin e Kamilo Toninin, drejtorin e Muzeut Correr dhe e përshkroi Karl von Gëgen si një figurë novatore dhe poliedrike, të njohur si veneciani me origjinë shqiptare, dhe e vlerësoi si një teknik të madh që përdori shkencën pozitiviste për progresin dhe dobinë e përgjithshme.

Fjalë përshëndetëse mbajti edhe prof. dr. Edmond Hajrizi, rektor i Universitetit UBT në Kosovë, i cili theksoi rëndësinë dhe interesin aktual të veprës së Karl Gegës, duke e përshkruar atë si një personifikim të lidërshiptit dhe inovacionit të Revolucionit Industrial. Ai theksoi kontributin e tij në zhvillimin ekonomik evropian dhe botëror.



Seancën e parë e hapi prof. Lucia Nadin me kumtesën “Historia e një familjeje dhe e një fisnikërie”, ku paraqiti dokumente të rëndësishme familjare, përfshirë letra, një stemë simbolike dhe pemën gjenealogjike të familjes Gega. Ajo theksoi prejardhjen shqiptare të familjes, duke shpjeguar se paraardhësit e Karlit ishin nga Perasti në gjirin e Kotorrit dhe ishin kapitenë të njohur të marinës veneciane. Mbiemri Gega lidhej me Gegninë në veri të Shqipërisë. Karl Gega lindi në Venecia në vitin 1802 dhe dokumentet e fëmijëve të babait të tij ruhen në kishën e Shën Pjetrit në Venecia. Gjithashtu, prof.

Nadin prezantoi medaljet e Kalorësit që Karl von Gega i mori për projektin e tij të famshëm të hekurudhës së Semmering-ut, duke vërtetuar gjenialitetin e tij.

Historiani Pëllumb Xhufi, në kumtesën “Detarë shqiptarë, shtetas venecianë nga gjiri i Kotorrit në shkëmbimet tregtare mes Venecias dhe Durrësit në shekullin XVIII” hodhi dritë mbi origjinën shqiptare të familjes Gega dhe lidhjen e tyre me marinën veneciane dhe komunitetet shqiptare në Dalmaci.

Marina Bressan-i theksoi rolin kyç të Karl von Gegës në ndërtimin e linjës hekurudhore të Semmering-ut, një nga arritjet më të mëdha inxhinierike të kohës, që konsiderohet si një kryevepër e gjenisë njerëzore. Ajo përmendi edhe ndikimin e tij në Trieste dhe në Vjenë, qendra kryesore të Perandorisë Habsburge.

Camillo Tonini prezantoi fondin Gega në Muzeun Correr, i pasur me dokumente, skica dhe letra që ndriçojnë jetën dhe veprën e Karl von Gegës, duke përfshirë lidhjen e tij me financiarin e shquar Simon Jorgo Sina me origjinë nga Voskopoja.

Seancën e dytë e hapi Giuseppe Razza, i cili foli për postën dhe për komunikimet në kohën e Karl Gegës, dhe paraqiti pulla postare e kartëmonedha me fytyrën e tij, si shenjë respekti për kontributin e çmuar.

Monica Genesini dhe Ina Arapi prezantuan kumtesën “Figura mitike e Gegës në letërsi”, ku analizuan ndikimin e veprës së tij inxhinierike në letërsinë austriake dhe formimin e legjendës popullore për Karl Gegën si një njeri gjenial që përballoi sfida të mëdha.

Në vazhdim, Alvin Saraçi, Monica Viero dhe Camillo Tonini paraqitën inventarin e fondit Gega në Muzeun Correr, që përmban mbi 300 mijë materiale të ndryshme, përfshirë vizatime, gravura, litografi, portrete dhe letërkëmbime.



Gjon Radovani, me kumtesën “Karl Gega, mendje gjeniale e shekullit XIX”, theksoi vizionin e tij për krijimin e një rrjeti hekurudhor europian, që do të lidhte rajone nga portet detare deri në zemër të Europës Qendrore. Ai e përshkroi Semmering-un si pjesë të një ideje më të madhe për një botë të ndërlidhur, koncept që do të zhvillohej më vonë nga futurizmi.

Në përmbyllje, akademik Gëzim Hoxha falënderoi pjesëmarrësit për kumtesat me nivel të lartë shkencor dhe nënvizoi rëndësinë e njohjes së plotë të personalitetit të Karl von Gegës, që na bën krenarë për origjinën shqiptare dhe rolin e tij si një figurë e madhe europiane.

-Pasqyrimi i veprimtarisë në media:

<https://www.youtube.com/watch?v=UAoHtshtmYU>

<https://shqiptarja.com/.../karl-gega-publikohen-dokumente...>

<https://www.youtube.com/watch?v=-hEu6fz7kYY>

https://www.youtube.com/watch?v=IEC1zU2S1_Y

www.akad.gov.al

Konferenca ndërkombëtare “Menaxhimi i integruar i burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit” – një platformë bashkëpunimi shkencor mbarëkombëtar



Në datat 29–30 maj 2025, në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua konferenca e dytë ndërdisiplinore në fushën e ujërave, një bashkorganizim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) nëpërmjet Njesisë kërkimore “Burimet ujore”, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

Veprimtaria u mbajt në nderim të akad. Salih Gashit, një nga themeluesit e kësaj nisme dhe pjesëmarrës i përhershëm në këto takime, i cili u nda nga jeta pak kohë përpara zhvillimit të kësaj konference.

Në këtë konferencë morën pjesë akademikë, lektorë dhe profesionistë nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe lektorë të ftuar nga Austria dhe Polonia, duke e bërë aktivitetin një platformë të gjerë shkëmbimi idesh dhe përvojash.

Në fjalën e hapjes, dr. Roza Allabashi theksoi rëndësinë e kësaj platforme si një urë bashkëpunimi ndërshqiptar e ndërkombëtar për çështjet e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Konferenca u përshëndet në emër të Kryesisë dhe të Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga zëvendëskryetari i saj, akad. Vasil Tole, i cili nënvizoi se kjo veprimtari përbën vazhdimësinë e një bashkëpunimi të nisur me sukses në Prishtinë dhe përfaqëson një model të shkëlqyer të integritit shkencor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.



Në fjalën e saj përshëndetëse, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Anila Denaj, e vuri theksin në rëndësinë e bashkëpunimeve akademike me rrjetin europian të kërkimit. Ajo theksoi sfidat e menaxhimit të burimeve ujore në kontekstin e ndryshimeve klimatike dhe nevojën për mbështetje të vazhdueshme institucionale.



Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit, z. Sofjan Jaupaj, theksoi se zhvillimi i turizmit duhet të jetë i pandarë nga menaxhimi i integruar i burimeve ujore dhe se përmbushja e kërkesave të Kapitullit 27 të Acquis Communautaire – i cili trajton mjedisin dhe ndryshimet klimatike – në kontekstin e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian, kërkon investime të mëdha dhe bashkëpunim ndërsektorial e ndërkufitar.

Në fjalën e tij përshëndetëse, akad. Fetah Podvorica theksoi rëndësinë e menaxhimit të përmirësuar të burimeve ujore si bazë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, veçanërisht në sektorë të ndjeshëm si turizmi dhe bujqësia. Ai nënvizoi nevojën për pastrimin dhe rikuperimin e burimeve të ndotura, si dhe për përfshirjen e institucioneve kërkimore në hartimin e politikave të qëndrueshme. Ndërkohë, akad. asoc. Besnik Baraj vuri në dukje rolin kyç të komunitetit shkencor në përballimin e sfidave të menaxhimit të ujërave, veçanërisht në kushtet e presioneve nga ndotja, urbanizimi dhe ndryshimet klimatike. Ai theksoi rëndësinë e përdorimit të informacionit shkencor për ndërtimin e politikave efektive dhe të qëndrueshme, si dhe rolin e edukimit për ndërgjegjësimin publik dhe forcimin e kapaciteteve vendimmarrëse.

Prof. Thomas Ertl, nga Universiteti BOKU, Austri, paraqiti risitë e direktivës së re të BE-së për trajtimin e ujërave të zeza urbane (2025), e cila promovon një qasje të integruar dhe të qëndrueshme në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Europiane. Një theks të veçantë në prezantimin e tij iu dha menaxhimit të ujërave të përmytjeve nëpërmjet zgjidhjeve natyrore, si çatitë e gjelbra dhe sipërfaqet e depërtueshme, për të përmirësuar qëndrueshmërinë klimatike në mjediset urbane.

Në dy ditët e konferencës u zhvilluan pesë sesione shkencore, gjatë të cilave u trajtuan çështje kyçe për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit. Temat u paraqitën në mënyrë ndërdisiplinore, duke përfshirë qasje nga shkencat natyrore, inxhinierike, mjedisore dhe sociale.



Temat e trajtuara ngjallën interes të veçantë në mesin e pjesëmarrësve, duke

nxitur diskutime të hapura dhe interaktive. U theksua rëndësia e ndërthurjes së dijes shkencore me politikëbërjen dhe përfshirja aktive e institucioneve akademike në hartimin e strategjive për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Diskutimet dëshmuar qartë se ruajtja e cilësisë së ujit është thelbësore për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, si dhe për forcimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në përmbyllje, akad. asoc. Besnik Baraj dhe akad. Fetah Podvorica nënvizuan se bashkëpunimi ndërmjet dy akademive ka krijuar një platformë të qëndrueshme për ndarjen e njohurive, nxitjen e projekteve të përbashkëta shkencore dhe ndërtimin e politikave të bazuara në evidenca shkencore. Konferenca e radhës do të mbahet në Prishtinë në maj të vitit 2026.



Ky aktivitet forcon rolin e shkencës si motor të zhvillimit të qëndrueshëm dhe konfirmon rëndësinë e menaxhimit të burimeve ujore si sfida dhe mundësi për Shqipërinë, Kosovën dhe më gjerë.

www.akad.gov.al

Nisin punimet dyditore të Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s

- Merr pjesë akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave-



Asambleja e Përgjithshme e ALLEA-s (Federata Europiane e Akademive të Shkencave Shoqërore dhe Natyrore) nisi punimet sot, në datën 3 qershor 2025. Kjo asamble mbledh çdo vit përfaqësues nga akademitë e shkencave të rreth 40 vendeve të rajonit të Këshillit të Europës.

Organizimi bëhet me mbështetjen e Akademisë Mbretërore Daneze të Shkencave dhe të Letërsisë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësohet nga akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së.

Në kuadër të veprimtarive do të mbahet simpoziumi me temën "Europa dhe Arktiku: Shkenca dhe diplomacia".

Këto rajone (Europa dhe Arktiku), pavarësisht nga karakteristikat e ndryshme gjeografike, kanë shumë të përbashkëta. Ato janë, së pari dhe kryesisht, pjesë e të njëjtit ekosistem dhe kanë elementë që varen nga njëri-tjetri në një marrëdhënie që i ka bërë gjithmonë e më shumë të dukshme në sfondin e ndryshimeve klimatike dhe tensioneve të rritura gjeopolitike. Në këtë simpozium do të shqyrtohet se si janë zhvilluar këto ndërvarësi, çfarë karakteristikash kanë dhe si mund të formësohet diplomacia e Arktikut e bazuar në kërkimin shkencor për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme dhe bashkëpunuese.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s do të mbyllet në datën 4 qershor 2025.

Shih linkun:

<https://www.youtube.com/watch?v=tEAY2uxeIJI>
www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca e tretë ndërkombëtare e Institutit Kombëtar të Fizikës

Në datat 2 dhe 3 qershor 2025 u mbajt konferenca e tretë ndërkombëtare e Institutit Kombëtar të Fizikës (IKF). Meqenëse 2025-a është shpallur viti ndërkombëtar i teknologjisë kuantike, konferenca pati në fokusin e saj arritjet madhore në këtë fushë qendrore të fizikës.

Veprimtaria u hap me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, i cili vlerësoi rolin e IKF-së si një qendër bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Ai theksoi angazhimin e ASHSH-së në përbashkëtimin e sfidës së emigrimit të trurit dhe në promovimin e dijeve bashkëkohore në fizikë, duke nxitur ekselencën dhe krijimin e një hapësire të përbashkët për fizikanët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Akad. Gjinushi nënvizoi gjithashtu përfshirjen aktive të shkencëtarëve shqiptarë të diasporës, të cilët kontribuojnë në punën e IKF-së njësoj sikur të ishin në Shqipëri.



Seanca e parë plenare, me temë “Fizika kuantike”, u moderua nga drejtoresha e IKF-së, akad. Mimoza Hafizi. Në këtë seancë, akad. Rexhep Meidani prezantoi referatin e tij mbi problemin e matjes në teorinë kuantike, ndërsa akad. Florian Vila dhe prof. dr. Fatos Ylli sollën kumtesën mbi kontributin e teorisë kuantike në strukturën atomike dhe aplikimet praktike të saj.

Më tej, në të njëjtën seancë, prof. dr. Robert Mochkovitch nga Instituti i Astrofizikës në Paris foli mbi “Shpërthimet e rrezeve gamma – shpërthimet më të fuqishme në Univers”, ndërsa Silvano Tosi nga Universiteti i Gjenovës paraqiti

temën mbi misionin “Euclid” dhe studimin e universit të errët.



Sesioni i dytë, i moderuar nga Silvano Tosi, përfshiu prezantimet e studiuesve: Albi Kerbizi (Universiteti Lund & INFN Trieste), Sefer Avdiaj (Universiteti i Prishtinës) dhe Dalin Boriçi (Universiteti Paris Cité), me tema që përfshinin ndërveprimet elektron-elektron në kavitate të modifikuara, fazat kuantike fraksionale të Hall-it, dhe modelimin e korrelacioneve kuantike.



Sesioni i tretë dhe i katërt i ditës së parë, të moderuara nga prof. Dodë Prenga (Departamenti i Fizikës, FSHN) dhe dr. Margarit Gjoka (INN, NCSR Demokritos, Greqi), iu kushtuan fizikës së trupit të ngurtë dhe shkencës së materialeve. Në to referuan studiues të njohur si: Karolina Gloëacka (Universiteti i Varshavës), Orion Çiftja (Prairie View A&M University, SHBA), Toni Shiroka (PSI & ETH Zyrih), Ardian B. Gojani (Secopta analytics, Gjermani), Orion Gërguri (PSI, Zvicër), dhe Mario Frakulla (Universiteti Drexel, SHBA).



Dita e dytë e konferencës përfshiu dy sesione tematike: “Fizika kompjuterike, simulimet dhe fizika mjekësore”, i moderuar nga dr. Albi Kerbizi, dhe “Kozmologji dhe astrofizikë”, i moderuar nga prof. dr. Robert Mochkovitch. Në këto sesione morrën pjesë studiues nga universitete dhe spitale kërkimore shqiptare dhe të huaja si: prof. dr. Hiqmet Kamberaj, prof. as. dr. Klaudio Peqini, dr. Xhulia Dosti, dr. Ervis Telhaj, prof. as. dr. Lindita Hamolli, Ester Oshafi, prof. as. dr. Odeta Çati, dr. Mendrit Latifi, Marsida Laze dhe dr. Alba Domi.

Në mbyllje të konferencës dyditore, u paraqitën konkluzionet mbi rëndësinë e shpërndarjes së rezultateve më të fundit të kërkimit shkencor në fizikë dhe teknologjinë kuantike, duke përfshirë edhe mësimdhënien. U diskutua gjithashtu mbi konsolidimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet fizikanëve shqiptarë dhe të huaj, si dhe zgjerimin e mëtejshëm të IKF-së me anëtarë të rinj.

Kjo ishte konferenca e tretë ndërkombëtare e organizuar nga IKF, pas atyre të mbajtura në shkurt 2022 dhe prill 2023, me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë edicion u realizuan 24 prezantime nga 70 studiues të njohur: 17 nga Shqipëria, 4 nga trojet shqiptare, 10 fizikanë shqiptarë të diasporës dhe 39 studiues të huaj nga institucione prestigjioze europiane dhe amerikane, si: Robert Mochkovitch (Instituti i Astrofizikës, Paris), Silvano Tosi (Universiteti i Gjenovës),

dhe përfaqësues të CERN-it.

www.akad.gov.al

U mbajt në Prishtinë konferenca shkencore me temën “Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës 1912–2008”

Kjo veprimtari u mbajt në datat 3 dhe 4 qershor 2025, në Prishtinë, dhe u organizua nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë, Tiranë, pjesë e Akademinë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Shkup.

Nga Instituti i Historisë, Tiranë (ASHSH), morën pjesë drejtori i këtij instituti prof. dr. Hamit Kaba, akad. Marenglen Verli; akad. Beqir Meta; prof. dr. Romeo Gurakuqi, prof. Ledia Dushku, prof. asoc. Gjon Boriçi, dr. Eduart Caka, prof. asoc. Sali Kadria, dr. Eralba Çiraku, dr. Jorina Verli.

Konferencën e hapi drejtoresha e Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, Teuta Shala-Peli. Ajo e vuri theksin në rolin jetik të diasporës si zë i çështjes kombëtare në botë dhe në fund të fjalës së saj e vlerësoi veprimtarinë për rëndësinë që ka në ndriçimin e çështjeve kombëtare.

Drejtori i Institutit të Historisë, Tiranë, prof. dr. Hamit Kaba, në fjalën përshëndetëse nënvizoi se diaspora ka qenë katalizator për ruajtjen e identitetit dhe interesave kombëtare. Ai theksoi ndër të tjera nevojën e studimeve të plota gjatë gjithë historisë shqiptare si faktorë urëlidhës i shqiptarëve me shtetin amë.



Fjalë përshëndetëse mbajti edhe prof. dr. Skënder Hasani, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (Shkup). Ai vlerësoi rolin e diasporës si bartëse e kujtesës kolektive, si dhe për ndikimin në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare.

Prof. dr. Hamit Kaba mbajti kumtesën me temën “Emigracioni shqiptar në SHBA gjatë Luftës së Ftohtë, raportet me vendin e lindjes dhe origjinën.

Akad. Marenglen Verli mbajti kumtesën me temën “Konferenca e paqes e Parisit dhe qëndrimet e diasporës dhe komiteti MKK për çështjet e Kosovës.



Akad. Beqir Meta mbajti kumtesën me temën “Qëndrimi i federatës panshqiptare “Vatra” ndaj zhvillimeve në Shqipëri në vitin 1921.



Prof. dr. Romeo Gurakuqi mbajti kumtesën me temën “Delegacionet e qeverisë së Durrësit dhe qeverisë së Tiranës në Bisedimet e Paqes në Paris 1919-1921.



Prof. asoc. Gjon Boriçi referoi studimin për problematikat e diasporës dhe emigracionit politik shqiptar në periudhën e luftës së ftohtë 1945-1959.

Prof. Ledia Dushku mbajti kumtesën me temën "Atdheu jashtë kufijve, diplomacia e diasporës dhe strategjitë e mobilizimit kombëtar 2012-2020".

Gjithashtu, paraqitën kumtesa: dr. Eduart Caka për mërgatën e shqiptarëve të Egjiptit dhe diasporën shqiptare të Amerikës; prof. asoc. Sali Kadria për kolonitë shqiptare të Egjiptit dhe pikëpamjet përfaqësuese të tyre për çështjet kombëtare; dr. Eralba Çiraku paraqiti kumtesën "Dokumente diplomatike për dëbimin dhe masakrat serbo-malazeze ndaj popullsisë shqiptare në vitet 1912-1913; dr. Jorina Verli paraqiti kumtesën me temën "Emigracioni politik dhe diaspora për çështjen Kosovës midis dy luftërave botërore-rasti Bedri Pojani".



Gjatë katër seancave të kësaj konference, rreth 50 studiues trajtuan rolin dhe

kontributin e diasporës shqiptare në raport me çështjen kombëtare dhe zhvillimet e Kosovës gjatë periudhës 1912–2008.

www.akad.gov.al

U mbajt forumi shkencor me temën "Programet e studimit të doktoraturës në fizikë e kimi; vlerësime e mendime për të ardhmen"

Veprimtaria u zhvillua në datën 5 qershor 2025 dhe u organizua nga Komisioni i fizikës e kimisë, pjesë e Akademisë së Shkencave, në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave për të aplikuar në studimet pasuniversitare, cikli i tretë (shkollat e doktoraturës), në drejtimet përkatëse të departamenteve të fizikës, kimisë, kimisë industriale (FSHN, UT) dhe inxhinierisë fizike (FIMIF, UP).

Në mbledhje ishin të pranishëm kryetari i Seksionit të shkencave natyrore e teknike akad. Neki Frashëri, kryetari i Komisionit akad. emeritus Florian Vila, akademikë, profesorë, anëtarë të komisionit drejtues e koordinatorë departamentesh dhe doktorantë.



Forumin e hapi akad. emeritus Florian Vila. Pasi falënderoi pjesëmarrësit, ai theksoi se organizimi i këtij forumi për ciklin e tretë të studimit universitar është në përputhje me ligjin dhe statusin e ASHSH-së, e cila ka për detyrë: vlerësimin e punës shkencore dhe etikës në shkencë; mbështetjen e programeve të studimit apo kërkimit; bashkëpunimin me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi, si institucionet e arsimit të lartë, institutet dhe qendrat e kërkimit, me qëllim që të koordinohet kërkimi shkencor dhe të përgatiten kërkuesit e rinj. Në zbërthim të këtij ligji dhe statusit të ASHSH-së, kryesia e Akademisë së Shkencave ka përcaktuar si fokus të bashkëpunimit në vlerësimin e nivelit dhe të cilësisë së transmetimit të shkencës në shkollimin universitar organizimin e programeve të ciklit të dytë e të

tretë.



Seanca e këtij forumi nisi me punimin e prof. asoc. Dhurata Premti e prof. dr. Spiro Drushku, të cilët trajtuan informacionet aktuale lidhur me standardet, arritjet dhe problematikat potenciale të kërkimeve shkencore në studimet e doktoratës.

Më pas, prof. dr. Ilirjana Boçi, prof. asoc. Gerti Xhixha, prof. as. Altin Gjevori, prof. asoc. Anila Dhroso trajtuan përvojat aktuale të departamenteve për metodologjinë e vlerësimit të aplikantëve në programet e doktoraturës në fizikë, kimi, prodhim industrial e inxhinieri dhe inxhinieri fizike.



Prof. dr. Rozana Troja paraqiti një këndvështrim për të kaluarën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për doktoraturë dhe ofroi qasje të

ndryshme pozitive, kontribuuese edhe për të ardhmen.

Prof. dr. Luljeta Pinguli, prof. dr. Ilirjana Boci, msc. Megi Çausi, msc. P. Drazho ofruan përvojat e doktorantëve në proces dhe udhëheqësve përkatës për të promovuar arritjet dhe për të propozuar zgjidhje për problematikat e evidentuara.

Prof. dr. Margarita Ifti, prof. dr. Altin Mele, prof. dr. Arjan Korpa paraqitën punimin “Shkollimi i doktoratës në BE, strukturat dhe modelet e reja”.

Akad. emeritus Floran Vila paraqiti një punim për doktoraturat e përbashkëta ndërkombëtare.

Prof. dr. Partizan Malkaj paraqiti punimin me temën “Njohja me eksperiencat individuale të doktoraturave jashtë vendit, në BE dhe në vende të tjera.

Në fund u zgjodh një komision që do të bëjë përmbledhjen e të gjitha propozimeve dhe problematikave të trajtuara.

www.akad.gov.al

U mbajt ligjërata me temën “Për një klasifikim tipologjik të modalitetit në gjuhën shqipe” nga dr. Leonard Dauti

Veprimtaria u zhvillua sot më 9 qershor 2025 dhe u organizua nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Departamenti i gramatikës dhe i historisë së gjuhës, pjesë e ASHSH-së. Morën pjesë kërkues të IGJL-së, si dhe kolegë të departamenteve të gjuhës nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Elbasanit.



Ligjëruesi u ndal në dy çështje kryesore: përshkrimi i klasifikimeve tipologjike të modalitetit në gjuhësinë europiane dhe ofrimi i një tipologjie që do të mund të shërbejë si një bazë metodologjike për analizën dhe përshkrimin e modalitetit të gjuhës shqipe.

Historiku i klasifikimit të modalitetit u parashtrua si sfond për të kuptuar dhe nxjerrë në pah evoluimin e mendimit gjuhësor për modalitetin dhe ndarjen e tij si kategori gjuhësore prej filozofisë dhe logjikës modale, nga njëra anë, dhe për të shtruar për diskutim problematikën e gjerë që ngërthen trajtimi i modalitetit në gjuhësi, nga ana tjetër.

Në lidhje me ofrimin e një tipologjie të modalitetit për rastin e gjuhës shqipe, u vu theksi në kriterin semantik si përcaktues i tipave modalë. Për argumentimin e përzgjedhjes së kriterëve u sollën dy qasjet kryesore në fushën e modalitetit: qasja e Kratzer-it, e cila krijoi një teori të vetën mbi modalitetin brenda kornizës së semantikës formale, duke shfrytëzuar konceptet e logjikës modale dhe duke ia përshtatur ato përshkrimit të modalitetit gjuhësor; qasja konjitiviste, e cila e vë

theksin në procesin konceptualizues të folësit në ngjizjen subjektive të modalitetit gjuhësor.



Synimi i ligjëruesit ishte që, duke u nisur nga të dhënat që ofron shqipja, të arrihet tek një tipologji e përshtatshme që i përgjigjet përshkrimit të sistemit të mjeteve të saj modale. Si tipa modaliteti për rastin e gjuhës shqipe autori është i mendimit se duhen pranuar: modaliteti epistemik, modaliteti deontik, modaliteti dinamik, modaliteti volitiv dhe modaliteti buletik. Për secilin tip u ofrua përkufizimi përkatës teorik, si dhe u përcaktuan nëndarjet përkatëse në bazë të shkallës së forcës modale, të ilustruara me një gamë të gjerë shembujsh nga gjuha e shkruar dhe e folur. Një vend të rëndësishëm në ligjëratë zuri edhe përshkrimi i mjeteve të shumta gjuhësore për shprehjen e kuptimeve të caktuara modale.

Ligjëratë u mbyll me diskutime dhe debate shkencore për çështje teorike mbi modalitetin, por edhe për çështje praktike të analizës dhe përshkrimit të sistemit modal të gjuhës shqipe.

U mbajt forumi shkencor “Meteorologjia dhe aviacioni 100 vjet në hapësirën shqiptare”

Me rastin e dy jubileve, 100-vjetorit të fluturimeve të para ajrore në hapësirën shqiptare dhe 75-vjetorit të Organizatës Botërore të Meteorologjisë, më 9 qershor 2025 u zhvillua forumi shkencor “Meteorologjia dhe aviacioni 100 vjet në hapësirën shqiptare”.

Veprimtaria u organizua nga Komisioni i fizikës e kimisë, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, pjesë e ASHSH-së. Seancën plenare e moderuan akad. emeritus Florian Vila, kryetar i Komisionit të fizikës, dhe prof. dr. Petrit Zorba.



Në fjalën e hapjes, akad. Vila tha se ky forum shkencor synon të mbledhë bashkë studiues e profesionistë të fushave të aviacionit dhe të meteorologjisë aeronautike në këtë vit jubile, si dhe të paraqesë një sërë informacionesh jo vetëm historike, por dhe shkencore e organizative apo me natyrë tjetër, për të përmirësuar punën në këto fusha me rëndësi jetike për vendin tonë. Studimet meteorologjike për motin dhe për kushtet atmosferike janë thelbësore për sigurinë, efikasitetin dhe ekonominë e aviacionit.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi përshëndeti dhe falënderoi organizatorët dhe pjesëmarrësit e forumit për organizmin e kësaj veprimtarie tejet të rëndësishme. Në fjalën e tij, ai theksoi se

Akademia e Shkencave i ka kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të kërkimeve shkencore në fushën e meteorologjisë. Në kuadër të reformimit të sistemit të kërkimit shkencor, është e domosdoshme që meteorologjia të zërë vendin që i takon me të drejtë, si një disiplinë me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme dhe politikatat e zhvillimit.



Ai vlerësoi se rekomandimet dhe sugjerimet që do të dalin nga diskutimet e këtij forumi, mund të jenë një mbështetje e çmuar për Akademinë e Shkencave për të rritur presionin dhe advokimin pranë qeverisë dhe politikëbërësve në funksion të forcimit të kërkimit shkencor në vend.

Ai shtoi, gjithashtu, se zhvillimet teknologjike dhe përparimi i inteligjencës artificiale ndihmojnë ndjeshëm në fushën e meteorologjisë dhe të aviacionit, për shkak të natyrës së ndërlikuar të modeleve. Për këtë arsye, është e domosdoshme që individët me aftësi të larta në matematikë të inkurajohen që të marrin përsipër sfida që lidhen me klimën dhe meteorologjinë.

Veprimtaria u përshëndet nga Armend Agushi, drejtor i IHM-së, Prishtinë, Kosovë, dhe Greg Brock-u, përgjegjës i Seksionit të Shërbimeve për Aviacionin, Organizata Botërore Meteorologjike (WMO), Gjenevë, Zvicër.

Në sesionin e parë me temën “Meteorologjia dhe aviacioni” u mbajtën kumtesa nga prof. dr. Petrit Zorba, UPT e Komisioni i Fizikës dhe Kimisë i Akademisë së Shkencave; Fatjon Demiraj, drejtor i Drejtorisë së Meteorologjisë, ALBCONTROL; Sherif Gosalci, Departamenti Meteorologjik, KANS, Prishtinë, Kosovë.

Pas përfundimit të sesionit të parë, të pranishmit vizituan ekspozitën “Shikim i ekspozesë mbi emetimet postare në kuadër të fluturimeve të para ajrore në Shqipëri

të vitit 1925", kuruar nga dr. Jovan Basho.

Në sesionin e dytë u trajtua çështja e sigurisë ajrore dhe ndryshimeve klimatike. Mbajtën kumtesa: dr. Parid Alimhillaj, ALBCONTROL; dr. Gazmir Çela, UPT; prof. asoc. Albana Hasimi, UPT; Besian Hysaj, KANS, Kosovë.



Në fund të veprimtarisë, referuesit përcollën tematika dhe ide me rëndësi për zhvillimet bashkëkohore në sektorin e monitorimit meteorologjik e po ashtu dhe të aviacionit, dy sektorëve të rëndësishëm dhe jetikë për ekonominë e vendit. U theksua rëndësia që ka meteorologjia për fushën e transportit në përgjithësi dhe atij ajror në veçanti, por dhe për degë të ndryshme të ekonomisë, për emergjencat civile dhe sigurinë kombëtare.

www.akad.gov.al

U mbajt forumi shkencor me temën “Risku sizmik dhe zvogëlimi i tij”

Veprimtaria u organizua nga Njësia kërkimore e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, UPT, dhe Institutin e Ndërtimit.

Forumi bëri bashkë kërkues shkencorë të fushës, studentë dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore nga vendi dhe rajoni, me synimin që të trajtojnë në mënyrë të gjithanshme çështjet që lidhen me riskun sizmik dhe mënyrat për uljen e tij.

Akad. asoc. Rrapo Ormeni, drejtuesi i Njesisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, çeli veprimtarinë dhe vuri në dukje se pas tërmetit të vitit 2019, Shqipëria ka kaluar në një strategji aktive për menaxhimin e riskut sizmik, që synon parandalimin, përgatitjen dhe planifikimin afatgjatë, e cila e ka afruar me standardet europiane. Risku sizmik nuk njeh kufij dhe kërkon qasje të koordinuara. Parandalimi mbetet masa më e drejtë dhe jetike për të ardhmen. Ne kemi një rol të rëndësishëm në integrimin e kërkimit shkencor, politikave të vlerësimit të riskut sizmik dhe teknologjive inovative për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.



Në sesionin e parë përshëndetën akad. Neki Frashëri, kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, ASHSH; dr. Adisa Bala, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; prof. dr. Neritan Shkodrani, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit; prof. dr. Naser Kabashi, Universiteti i Prishtinës.

Në sesionin e dytë, i cili u moderua nga prof. Niko Pojani e prof. Hüseyin Bilgin, u trajtua tema e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut sizmik. Rreth kësaj teme u mbajtën kumtesa nga dr. Adisa Bala, AKMC; prof. asoc. Kemal Edip, IZIIS, Maqedonia e Veriut; dr. Kristina Matraku, UPT; msc. Rikard Luka, Instituti i Ndërtimit; prof. dr. Naser Kabashi (Kosovë); dr. Enes Veliu, Itali; prof. asoc. Markel

Baballëku, UPT.

Në sesionin e tretë u trajtuan veçoritë dhe faktorët ndikues në riskun sizmik. Ky sesion u moderua nga prof. dr. Naser Kabashi dhe dr. Enes Veliu. Mëbajtën kumtesa Elona Pojani, UT; prof. Hüseyin Bilgin, Universiteti Epoka; prof. Arian Lako, UPT; dr. Bledar Kalemi, UPT; prof.asoc. Klodian Skrame UPT; dr. Endri Duro, Universiteti Polis.



Moderatorët, prof.dr. Kemal Edip dhe prof. asoc. Markel Baballëku, pas diskutimeve të çështjeve kryesore që lidhen me riskun sizmik në nivelin kombëtar dhe sfidat përkatëse; masat e ndërmarra pas tërmeteve të vitit 2019 për parandalimin dhe reduktimin e riskut sizmik; ndikimin e riskut sizmik në kodet e ndërtimit me fokus në Eurokodet e gjeneratës së dytë e më gjerë, përmbyllën aktivitetin me diskutime dhe konkluzione.

-Pasqyrimi i veprimtarisë në media:

<https://www.oranews.tv/.../risku-sizmik-dhe-zvogelimi-i-...>

<https://ata.gov.al/.../risku-sizmik-dhe-zvogelimi-i-tij...>

<https://www.youtube.com/watch?v=miVkjB1fpiY>

<https://www.youtube.com/watch?v=5289TjO6ErM>

<https://scantv.al/.../shqiperia-ne-harten-e-kuqe-sizmike...>

www.akad.gov.al

Akad. Adrian Civici mbajti ligjëratën: “Drejt universiteteve 4.0. - Si po e revolucionarizon teknologjia dhe inteligjenca artificiale edukimin”

Në mbledhjen e Komisionit të përhershëm të ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike, zhvilluar sot, më 17 qershor 2025, akad. Adrian Civici paraqiti ligjëratën me temën: “Drejt universiteteve 4.0. - Si po e revolucionarizon teknologjia dhe inteligjenca artificiale edukimin”.



Veprimtarinë e hapi kryetari i Komisionit, akad. Anastas Angjeli, i cili e vuri theksin në domosdoshmërinë e rritjes së performancës së sistemit universitar dhe kërkimit shkencor, si rrjedhojë e zhvillimit të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, për të shkuar drejt formatimit të universitetit 4.0.

Fillimisht akad. Civici foli për rolin dhe vendin e universiteteve në shoqërinë tonë në shek. XXI, për misionin e universiteteve në funksion të përhapjes së dijes, cilësisë së studentëve të diplomuar, kërkimit shkencor, inovacionit dhe revolucionit 4.0, si dhe për ndikimin e globalizimit dhe revolucionit teknologjik në “formatimin” e universiteteve të së ardhmes. Ky formatim mbështetet në katër forcat e mëdha të ndryshimit të botës moderne: stimulimin e teknologjive të reja; përballimin dhe përfitimin nga efektet e globalizimit; formimin e kapitalit social cilësor; përmirësimin e mirëqeverisjes.

Ai paraqiti modelet më të mira të organizimit, si dhe elementet e ndikimit të IA-së në transformimin e universiteteve nëpërmjet një historiku të shkurtër të revolucioneve të universiteteve (1.0; 2.0; 3.0) dhe u ndal në rëndësinë e revolucionit të katërt dhe “Universitetet e së ardhmes 2050”, duke e përcaktuar si një epokë në të cilën do të sfidohen hierarkitë tradicionale të statusit të universiteteve. Universiteti 4.0 synon të zbatojë paradigmen e industrisë 4.0 dhe “spiralen e katërfishtë” në universitete për të nxitur automatizimin, përshtatjen dhe personalizimin e proceseve

të të nxënit.



Në fund, akad. Civici dha disa konkluzione të rëndësishme, që dëshmojnë nevojën e vendit tonë për përmirësimin e universiteteve apo kolegjeve profesionale, të cilat janë ende shumë larg modelit të universiteteve 4.0. Në shumicën dërrmuese të rasteve mbizotërojnë format dhe modelet klasike të organizimit dhe funksionimit të universiteteve me elemente të modeleve 2.0 dhe 3.0. Në këtë drejtim mungojnë njohuritë e duhura dhe përvojat e përparuara, si dhe politikat specifike për transformimin e universiteteve shqiptare sipas modelit 4.0. Kjo situatë po ndikon dhe në performancën dhe përfitimet nga bashkëpunimi ndërkombëtar e procesi i ndërkombëtarizimit të universiteteve shqiptare.

www.akad.gov.al

Tryezë e rrumbullakët: “Studimet historike shqiptare sot: sfida dhe probleme”

Veprimtaria u organizua nga Komisioni i përhershëm i historisë, pjesë e Akademisë së Shkencave. Tryeza shkencore u mbajt në praninë e akad. Skënder Gjinushit, kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; akad. Anila Hodës, sekretares shkencore të ASHSH-së; akad. Gëzim Hoxhës, Kryetarit të Seksionit Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASHSH, dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Institutit të Historisë, Komisionit të përhershëm të historisë, profesorë e studiues të Universitetit të Tiranës, si dhe përfaqësues nga Drejtoria Qendrore e Arkivave.

Prof. Paskal Milo, kryetari i Komisionit të përhershëm të historisë, u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe falënderoi akad. Skënder Gjinushin për praninë dhe mbështetjen e kësaj veprimtarie, në një kohë kur çështja e historisë së shqiptarëve përbën një shqetësim të vazhdueshëm me problematikat që ka e sfidat që duhet të përballojë.



Kryetari i akademisë në fjalën e tij tha se tematika e kësaj tryeze të rrumbullakët trajtohet në një moment kulmor, siç është dorëzimi i veprës madhore të “Historisë së shqiptarëve” në katër vëllime, ku tashmë janë përfunduar dy vëllimet e para. Ai vlerësoi edhe punën e historianëve të angazhuar në hartimin e kësaj vepre nën drejtimin e prof. dr. Cekës për periudhën e antikitetit; akad. Pëllumb Xhufit për periudhën e mesjetës, si dhe prof. dr. Milos e prof.dr. Dukës për vijimin e punës me dy vëllimet e tjera. Ai vlerësoi se ky takim pune do të shërbejë në hapjen e

disa rrugëve për të paraqitur “Historinë e shqiptarëve” në mënyrë të paanshme për ato çështje që ofrojnë debatet më të nxehta.

Prof. Paskal Milo mbajti kumtesën me temën “Studimet historike shqiptare, sfida dhe probleme”, ku u ndal në disa aspekte të rëndësishme të problematikave dhe të sfidave që ka historiografia jo vetëm në Shqipëri, por që janë të reflektuara edhe në përvojën botërore, siç është politizimi i historisë. Ky fenomen shfaqet me përdorimin selektiv të botimeve, glorifikimin e disa periudhave, ngjarjeve dhe individëve historikë, dhe në denigrimin e disa të tjerave, në mohimet apo shtrembërimet e tyre, si dhe në keqinterpretimin e kontributeve përmes etiketimeve politike, në hartimin e kurrikulave dhe botimeve të teksteve shkollore, në ngritjen e komisioneve historike, si dhe në imponimin e klisheve në interpretimin e ngjarjeve dhe fakteve historike.



Sipas tij, kjo fushë e shkencës po përballet gjithashtu dhe me krizën e burimeve arkivore, që rrjedh nga kufizimet në shfrytëzimin e arkivave, nga censura dhe mosrespektimi i afateve të deklasifikimit të dokumenteve etj., të cilat rrezikojnë të krijojnë një histori të fragmentarizuar. Ai u ndal në çështje, si: raporti midis historisë globale dhe historisë kombëtare; roli i teknologjisë dhe i inteligjencës artificiale në historiografi; rivlerësimi i figurave historike në dritën e standardeve të sotme morale; instrumentalizimi i historisë në politikën dhe konfliktet bashkëkohore etj.

Si pasojë e mungesës së investimeve në kërkimin shkencor, disa nga problemet aktuale në këtë drejtim janë: përballja me narrativat nacionaliste, e

kaluara ideologjike dhe trashëgimia e saj, mungesa e kritikës dhe debatit akademik; mungesa e ndërkombëtarizmit dhe përfshirjes në debate globale. Një sfidë themelore në raportin midis globalizmit dhe historisë së identitetit kombëtar e kulturor mbetet nevoja për riformatimin metodologjik dhe etik në historiografi. Historiografia shqiptare është në një pikë kthese; ajo s'mund të mbetet peng i narrativave të vjetra, por duhet të ndërtojë një kulturë historike të bazuar në kërkimin objektiv, kritikën e hapur dhe përballjen me të kaluarën pa komplekse. Vetëm në këtë mënyrë historia mund të shërbejë jo si një mit për konsum politik, por si një mjet për kuptim, pajtim dhe nderim të së ardhmes në mënyrë të ndershme dhe të qëndrueshme.



Prof. dr. Ferit Duka në kumtesën me temën “Historiografia dje dhe sot: arritje dhe probleme” dha një pasqyrim të gjendjes së historisë së sotme të shkruar në dy periudha, periudha e komunizmit dhe postkomunizmit. Ai tha se në të dyja periudhat partitë politike shqiptare dhe udhëheqësit e tyre kanë pasur një prirje të qartë për ta përdorur historinë në funksion të nevojës për legjitimitet dhe fuqizim të pozicionit të tyre në shoqëri. Sipas tij, ky fenomen ka ushqyer edhe historiografinë amatore, e cila, për fat të keq, ka qenë shumë e zëshme në media dhe në veprimtari të tjera me karakter publik. Sot kërkohen studime historike cilësore dhe për këtë nevojiten historianë cilësorë, me imunitet të fortë ndaj presioneve manipulative të originave të ndryshme. Kjo është një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballlet historiografia jonë në ditë e sotme.

Tryeza u mbyll me kumtesën “Apatia historike e brezit të ri dhe sfida e rizgjimit të ndërgjegjes kolektive” e prof. dr. Arben Cici. Në trajtesën e tij, ai u ndal në efektet që kanë rrjetet sociale dhe teknologjia tek brezat e rinj të cilët po

distancohen gjithnjë e më tepër nga e kaluara, po e perceptojnë historinë si të largët, të mërzitshme dhe shpeshherë të parëndësishme për të tashmen apo të ardhmen. Ky fenomen është global dhe vjen si rezultat i një ndërthurjeje faktorësh edukativë, kulturorë dhe teknologjikë, që i kanë kthyer të rinjtë në konsumatorë të informacionit të çastit dhe jo të dijes me rrënjë të thella historike; është një çështje që prek thelbësisht edukimin, identitetin kombëtar dhe kohezionin shoqëror. Studimet mbi edukimin historik tregojnë se mungesa e analizës historike çon në paaftësinë për të kuptuar rrënjët e fenomeneve aktuale, siç janë populizmi, nacionalizmi ekstrem dhe autoritarizmi. Brezi i ri po bëhet më i prekshëm ndaj narrativave të rreme, propagandës dhe populizmit.

Në këtë drejtim, prof. dr. Cici propozoi disa ide për shmangien e këtyre fenomeneve negative si: reformimi i kurrikulës së lëndës së historisë; qasja e re didaktike e mbështetur në mendimin kritik dhe ndërtimin e interesit ndaj historisë; përdorimi i teknologjisë si mjet ndihmës për aplikime të realitetit virtual që simulojnë ngjarje historike, dokumentarë interaktivë e platforma të tjera; aktivizimi përmes projektit dhe kujtesës aktive; angazhimi i të rinjve në projekte kujtese (vizita në kampe përqendrimi, monumente përkujtimore, ekspozita); shembuj dhe përvoja konkrete nga vendet e tjera etj.

Në fund të veprimtarisë, pjesëmarrësit zhvilluan diskutime rreth fenomeneve dhe çështjeve më thelbësore të trajtuara nga kumtuesit.

www.akad.gov.al

U mbajt forumi ndërkombëtar “Arkitektura e peizazhit në Shqipëri: sfida dhe potenciale”

Veprimtaria u zhvillua më 26 qershor 2025 me pjesëmarrjen e studiuesve dhe ekspertëve të arkitekturës së peizazhit e disiplinave të afërta nga Shqipëria, Italia, Hungaria, Greqia dhe Rumania.

Organizatore dhe ideatore e këtij forumi është Njësia e përkohshme e kërkimeve gjeografike, pjesë e Akademisë së Shkencave, në bashkëpunim me Departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit dhe Shoqatën e Arkitektëve të Peizazhit të Shqipërisë.

Akad. Gëzim Hoxha, Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, përshëndeti pjesëmarrësit e forumit në emër të Kryesisë së ASHSH-së dhe falënderoi për kontributin në këtë veprimtari veçanërisht presidenten e Federatës Ndërkombëtare të Arkitektëve të Peizazhit, IFLA, prof. Katerina Gkoltsiou-n; sekretaren e përgjithshme të IFLA-s, dr. Diana Lavinia Culescu-n, prof. Giulio Senes-in, Universiteti i Milanos; Abertt Fekete-n, Universiteti i Shkencave të Jetës e Bujqësisë, Budapest, si dhe arkitektin Guust Selhorst-in, themeluesin e drejtuesin e të parës studio të arkitekturës së peizazhit në Shqipëri (JESHILE Landscape Design), si dhe institucionet mbështetëse: ASHSH-në, Universitetin Bujqësor të Tiranës etj, të cilat japin ndihmesën për konsolidimin e këtij drejtimi të ri të studimeve shkencore shqiptare. Ai theksoi se forumi i sotëm nuk është thjesht një ngjarje akademike. Këtu duhet të fillojnë përpjekjet serioze për një dialog ndërdisiplinor për ndërtimin e një vizioni të përbashkët dhe për nxitjen e politikave afatgjata, që e vendosin arkitekturën e peizazhit në qendër të zhvillimit bashkëkohor dhe të qëndrueshëm të vendit.



Më pas përshëndeti prof. dr. Perikli Qiriaz, drejtuesi i Njesisë së kërkimeve gjeografike, pjesë e ASHSH-së. Ai tha se forumi synon që nëpërmjet diskutimeve, argumenteve dhe qasjeve ndërdisiplinore të analizojë problemet komplekse të fushës së re studimore të arkitekturës së peizazhit në Shqipëri, për të gjetur pika takimi midis gjeografisë e shkencave të tjera me arkitekturën e peizazhit dhe, mbi këtë bazë, të ndërtohen projekte të përbashkëta për të zgjidhur problemet dhe sfidat e mëdha, me të cilat përballen vendbanimet, peizazhet natyrore të degraduara apo të dezertifikuara aq të shumta në vendin tonë.



Fjalë përshëndetëse mbajti edhe presidentja e IFLA-s, prof. dr. Katerina Gkoltsiou, e cila e vuri theksin tek roli që luan arkitektura e peizazhit për luftimin e ndryshimeve dhe sfidave klimatike.

Forumi u drejtua nga prof. dr. Zydi Teqja dhe seancat u moderuan nga prof. dr. Bilal Draçi, prof. asoc. dr. Gjok Vuksani, prof. dr. Zydi Teqja, prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri.

Përmes 10 punimeve shkencore të paraqitura në këtë forum nga referuesit prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri; prof. dr. Perikli Qiriaz; prof. dr. Dhimitër Doka; prof. asoc. dr. Ermir Hoxha; dr. Artan Hysa; prof. dr. Zydi Teqja; arkitekti Kreshnik Merxhani; prof. dr. Katerina Gkoltsiou, prof. Giulio Senes; prof. dr. Albert Fekete; arkitekti Guust Selhorst u trajtua një spektër i gjerë temash.

Referuesit u përqendruan në historinë e arkitekturës së peizazhit në Shqipëri; detyrat e arkitekturës së peizazhit në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave urbane dhe vlerësimin e burimeve të peizazhit natyror dhe kulturor, vjeljen përvojave nga vendet e tjera europiane, sfidat dhe potencialet e arkitekturës së peizazhit në Shqipëri, si dhe strategjitë më të mira për të promovuar arkitekturën e peizazhit në Shqipëri etj.



Në fund u bënë diskutime të hapura rreth referateve të mbajtura dhe miratimi i dokumentit përfundimtar.
www.akad.gov.al

Arkeologët zviceranë dhe shqiptarë përmbyllin fazën e parë të gërmimeve në Lin të Pogradecit.

Ky projekt është realizuar nga Universiteti i Bernës dhe Instituti i Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në bazë të zbulimeve dhe studimeve të bëra, ata e kanë datuar vendbanimin mbi 8000-vjeçar.



Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, znj. Ruth Huber, gjatë vizitës në terren, vlerësoi përkushtimin e palës shqiptare dhe theksoi rëndësinë e këtij projekti për shkencën dhe bashkëpunimin me institucionet shqiptare.



Lexo linkun:

<https://www.facebook.com/share/16Y753MpBQ/>

[#AShSh](#)

[#InstitutiiArkeologjisë](#)

[#UniversitetiiBernës](#)

[#Switzerland](#)

[#Albania](#)

www.akad.gov.al

Vizitë pune

Vizitë zyrtare e delegacionit të Akademisë së Shkencave Sociale të Shangait në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Në datën 8 qershor 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u prit në një vizitë zyrtare një delegacion me përfaqësues të Akademisë së Shkencave Sociale të Shangait.

Delegacioni përbëhej nga prof. Yao Jianlong, nënkryetar dhe drejtor i Institutit të Drejtësisë, SASS; prof. asoc. Wang Jianghuai, Instituti i Drejtësisë, SASS; Fan Huihui, oficerë programi, Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, SASS.



Delegacioni përfaqësues i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përbëhej nga akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së; akad. asoc. Gëzim Hoxha, Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike; akad. Aurela Anastasi, Komisioni i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike; prof. asoc. Elda Zotaj, drejtuese e zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun.

Akad. Anila Hoda i uroi mirëseardhjen delegacionit në emër të Kryesisë së ASHSH-së dhe shprehu falënderimet për interesin e treguar për të vizituar Akademinë e Shkencave. Ajo e njohu delegacionin kinez me zhvillimet më të rëndësishme të ASHSH-së dhe e vuri theksin në punën që po bëhet në institutet dhe qendrat kërkimore të institucionit për kërkimin shkencor në fushat e biologjisë, nanoteknologjisë, energjetikës, ujërave, mjekësisë, bujqësisë e më gjerë, studiuesit e të cilave kanë dhënë kontribute në rrjetin e shkencëtarëve europianë me vendosjen e

bashkëpunimit me qendra ndërkombëtare të kërkimit shkencor.

Gjithashtu, ajo theksoi se ASHSH-ja i kushton një vëmendje të veçantë mbështetjes së punës kërkimore shkencore të studiuesve të rinj dhe kjo reflektohet me ngritjen e Akademisë së të Rinjve pranë këtij institucioni.



Më tej, akad. Hoda foli për tri projektet e mëdha të ASHSH-së, ku aktualisht po bëhet një punë e përqendruar për “Enciklopedinë shqiptare” dhe “Historinë e shqiptarëve”. Ajo e vuri theksin në reformimin e ASHSH-së. Bashkimi i instituteve nën drejtimin e saj ka krijuar tashmë bashkëpunime në shkallë ndërkombëtare. Gjithashtu, ajo bëri dhe një paraqitje të veprimtarive të përbashkëta më të rëndësishme të bashkëpunimit mes ASHSH-së dhe institucioneve kërkimore kineze.

Në fjalën e tij, kryetari i delegacionit, prof. Yao Jianlong shprehu falënderime për organizmin e këtij takimi. Ai tha se Kina me Shqipërinë ka një miqësi tradicionale dhe ka pasur dëshirë të madhe ta vizitojë këtë vend. Më pas, ai foli për historikun e Akademisë së Shkencave Shoqërore të Shangait (SASS), e cila u krijua në vitin 1958 dhe është institucioni më i vjetër në Kinë. SASS-i ka 17 institute shkencore dhe mbi 20 qendra ndërdisiplinore, të cilat zhvillojnë kërkime teorike dhe të aplikuara për çështje thelbësore që dalin nga politikat e reformës dhe hapjes së vazhdueshme të Kinës, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ka rreth 800 punonjës, përfshirë dhe 550 studiues. Drejtimet përfshijnë ekonomi, kulturë, teknologji, sociologji, fusha ligjore etj. Një punë e rëndësishme është dhe bashkëpunimi me institucionet kërkimore nëpër botë, që mundëson krijimin e një ure lidhëse mes SASS-it dhe ASHSH-së.

Në kuadër të interesit për bashkëpunim u bënë pyetje e diskutime për

përvojat e punës dhe mënyrën e drejtimit të kërkimit shkencor në institucionet përkatëse, për të lehtësuar marrëdhëniet në fusha me interes reciprok. Në lidhje me formalizimin e bashkëpunimit përmes një marrëveshjeje të përbashkët, akad. Hoda tha se ASHSH-ja është e interesuar dhe e hapur për bashkëpunime që zhvillojnë kërkimin shkencor dhe aktivitetet e përbashkëta kërkimore, sidomos për përfshirjen e kërkuesve të rinj dhe u shpreh se do të vijojnë bisedat me kryesinë e këtij institucioni për të hedhur hapa konkretë për formalizimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Në përmbyllje të takimit të dyja palët shprehën vullnetin për të vijuar komunikimet përmes zyrave të bashkëpunimit ndërkombëtar.

www.akad.gov.al

Të reja nga bota akademike

Akademik Nazim Gruda merr diplomën si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Lituanisë



Në mbledhjen solemne të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Lituanisë (Lietuvos Mokslų Akademija, LMA) më 17 qershor 2025 u mbajt ceremonia e dorëzimit të diplomave për anëtarët e jashtëm të pranuar në këtë akademi.

Me këtë rast, akad. Gruda mbajti kumtesën me temën “Hortikultura në epokën e ndryshimeve klimatike”. Ai ndau me akademikët lituanezë dhe pjesëmarrësit e institucioneve shkencore europiane perspektivën e tij për sfidat dhe mundësitë që has bujqësia përballë kushteve ekstreme klimatike.

Në ceremoninë solemne akad. Grudës iu dha diploma e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Lituanisë në Seksionin e shkencave bujqësore dhe pyjore. Zgjedhja e tij u bë më 8 prill 2025 nga Asambleja e LMA-së.

Bashkëlidhur linku i ceremonisë:


<https://drive.google.com/.../11.../view...>

www.akad.gov.al

Botime të reja

Doli numri i parë i revistës shkencore “Albanian Studies” për vitin 2025!

Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë




Revista “Albanian Studies” sjell kontributet më cilësore të mendimit shkencor shqiptar, duke përfshirë punime nga institutet kërkimore të Akademisë së Shkencave, por edhe nga studiues të tjerë brenda dhe jashtë vendit.

Me një standard të lartë akademik dhe të hapur për publikime të mirëfillta shkencore, revista botohet në gjuhën angleze dhe është me ISSN (International Standard Serial Number)

Lexo linkun: [ALBANIAN STUDIES NR. 1, 2025 - Google Drive](#)

Të tjera

Urim për 89-vjetorin e lindjes së akademikut Rexhep Qosja



I nderuar akademik Rexhep Qosja,

Me rastin e 89-vjetorit të lindjes suaj, Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka nderin dhe kënaqësinë t'ju përcjellë urimet më të përzemërta për shëndet të mirë, jetë të gjatë dhe vazhdimësi të frytshme në veprimtarinë tuaj të pasur krijuese dhe intelektuale.

Jeta dhe vepra juaj janë të lidhura pazgjidhshmërisht me historinë e mendimit shkencor, letrar dhe politik të botës shqiptare. Me një veprimtari të gjithanshme e të pandërprerë, më shumë se gjysmëshekullore si studiues, shkrimtar, mendimtar dhe protagonist i proceseve kombëtare, ju keni qenë dhe do të mbeteni një nga figurat më të shquara të kulturës dhe vetëdijes sonë kombëtare.

Kontributi juaj në historinë e letërsisë shqipe, në kulturën kombëtare dhe në çështjen shqiptare, drejtimi afatgjatë i Institutit Albanologjik të Prishtinës, krijimtaria si romancier dhe eseist, pjesëmarrja aktive në momente kyçe të historisë politike, përfshirë Konferencën e Rambujesë, si dhe zëri juaj kritik në mbrojtje të vlerave demokratike, kanë bërë që emri dhe vepra juaj të zënë një vend të përhershëm në kujtesën shkencore, letrare dhe shoqërore mbarëkombëtare.

Në këtë ditë të veçantë Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ku ju gëzoni statusin e anëtarit të nderit, ju uron gëzuar ditëlindjen! Shëndet, mbarësi dhe

frymëzim të pandërprerë në përpjekjet tuaja të vyera për dijen, kulturën dhe atdheun e përbashkët.

Me nderime të larta dhe respekt të veçantë,
Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.


Tiranë, 25 qershor 2025

#AShSh

www.akad.gov.al

Vizitë zyrtare e akad. Skënder Gjinushit në fondet arkeologjike të Durrësit

Akademik Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi më 26 qershor 2025 një vizitë inspektuese në fondet arkeologjike të Durrësit, në kuadër të monitorimit të punimeve për transferimin dhe sistemimin e fondit arkeologjik të Institutit të Arkeologjisë në Durrës.



Vizita u përqendrua në procesin teknik të zhvendosjes së materialit arkeologjik nga godina e mëparshme, e cila aktualisht do t'i nënshtrohet një rikualifikimi tërësor si pjesë e projektit të rikonstruksionit të Muzeut Arkeologjik të Durrësit. Materialet janë transferuar dhe po sistemohen në një strukturë të re dhe të dedikuar, ngritur enkas për të garantuar ruajtjen, administrimin dhe aksesin shkencor të fondeve arkeologjike.

Akad. Gjinushi u njoh nga afër me kushtet teknike të ruajtjes së materialit, organizimin e inventarit, si dhe me punën e stafit specialist në këtë proces delikat që synon të sigurojë vazhdimësinë e kërkimit shkencor dhe trashëgimisë arkeologjike të qytetit antik.

Kjo nismë përfaqëson një hap të rëndësishëm në drejtim të standardizimit të infrastrukturës së ruajtjes muzeale dhe të burimeve arkeologjike, si edhe një model i bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare.

www.akad.gov.al

Specialistët e informacionit në institucionet kërkimore marrin licensa për digjitalizimin e veprimtarisë shkencore

Si pjesë e strategjisë për forcimin e infrastrukturës së informacionit shkencor dhe rritjen e transparencës në kërkimin akademik në vend, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, përmes Qendrës për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH), përmbylli me sukses procesin e trajnimeve dhe testimit profesional të specialistëve të informacionit.

Pas përfundimit të këtyre fazave intensive të përgatitjes, specialistët u pajisën me licensat (lejet) për përdorimin e platformave ECRIS.AL dhe COBISS.AL, dy sisteme kyçe për menaxhimin dhe vlerësimin e veprimtarisë shkencore në Shqipëri.

Specialistët e informacionit, duke përfshirë edhe stafin e Bibliotekës Shkencore të Akademisë së Shkencave, janë tashmë të certifikuar dhe të licensuar për përdorimin e këtyre platformave, të cilat shërbejnë si mjete thelbësore për përhapjen e informacionit shkencor.



Ky hap përforcon aftësitë profesionale të stafit dhe është një fazë e rëndësishme drejt digjitalizimit dhe integritit të plotë të Shqipërisë në rrjetet ndërkombëtare të informacionit shkencor.

Informacioni i plotë i digjitalizuar krijon mundësinë për përfshirje në projekte bashkëpunimi për një akses të hapur të kërkimit shkencor në nivel ndërkombëtar.

Nëpërmjet këtij procesi, Akademia e Shkencave synon të rrisë vizibilitetin, bashkëveprimin dhe aksesin më bashkëkohor të veprimtarisë kërkimore ndaj dijes dhe kërkimit shkencor.

Përdorimi i sistemeve ECRIS.AL dhe COBISS.AL do t'u mundësojë specialistëve të realizojnë:

- digjitalizimin e veprimtarisë kërkimore të studiuesve të Akademisë dhe institucioneve kërkimore sipas standardeve ndërkombëtare;
- menaxhimin e bibliografive online të kërkuesve shkencorë dhe vlerësimin e rezultateve të kërkimit;
- ofrimin e metadatave për ndërveprimin e të dhënave dhe rezultateve të kërkimit;
- promovimin dhe aksesin e prurjeve shkencore.

Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të frytshëm midis Akademisë së Shkencave dhe institucioneve partnere që mbështesin zhvillimin e infrastrukturës digjitale në fushën e shkencës dhe teknologjisë së informacionit.

Në vijim do të organizohen trajnime të mëtejshme dhe aktivitete për të fuqizuar më tej kapacitetet profesionale të specialistëve të informacionit dhe për të promovuar përdorimin e gjerë të platformave digjitale në institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore në Shqipëri.

www.akad.gov.al